



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:224687

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05661567

P.nr.523/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit N. G., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.6314/23, të datës 24.10.2023, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datë 02.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të dëmtuarit të miturit F. B. dhe përfaqësuesit të tij ligjor babait F. B., të pandehurit dhe mbrojtëses së sipas detyrës zyrtare av. B. Sh. – M., me datë 03.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, si dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

N. G., nga i ati N. dhe nëna A. e vajzërisë V., i lindur më ... në fshatin D., Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion kuzhinier në picerinë “H. P.” në P., i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë për vepra tjera penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Me datë 01.10.2023, rreth orës 05:00, në P. saktësisht tek rrethi për në fshatin K., skaj rrugës te lokali “M.”, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, duke përdorur forcën, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër dhe atë të dëmtuarit F. B., në atë mënyrë që i pandehuri derisa ishte duke u kthyer në shtëpi, e kishte pa biçikletën e cila ka qenë e kyçur me dry dhe biçikletën e kishte tërhequr me forcë ku e dëmton drynin e biçikletës, më pas e merr të njëjtën dhe largohet për në shtëpinë e tij kurse i njëjti identifikohet nga kamerat e qytetit përmes video-incizimit, me ç ‘rast tek i njëjti gjenet dhe sekuestrohet biçikleta e cila më pas i kthehet të dëmtuarit.

- me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 52, 53, 56 par. 1 nën-par. 1.8, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së, 242, 364, 367 dhe 449 par. 2 nën. Par. 2.6 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N DËNIM ME GJOBË dhe DËNIM ME KUSHT

- I. Ashtu që i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) Euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
- II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Në dënimin me kusht përfshihet URDHRI për përmbushjen e detyrimit “Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës”.
- IV. Nëse i pandehuri nuk përmbushë kushtin e përcaktuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do ta revokojë dënimin me kusht dhe do të ekzekutojë dënimin i cili është caktuar në dënimin me kusht.
- V. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- VI. I mituri F. B. dhe përfaqësuesi ligjor i tij babai F. B., me vendbanim në Rr. “E. M.” pn. P., nuk parashtruan kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.6314/23, të datës 24.10.2023, N. G., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.05.2024, në të cilën pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPPRK-së, të njëjtit i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet duke e pranuar në tërësi gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë, se natën

kritike derisa ka qenë duke u kthyer në shtëpinë e tij në fshatin D. të P., rreth orës 05:00 të mëngjesit, tek rrethi i K., nën ndikimin e alkoolit dhe për shkak të motit të ftohtë, ka marr biçikletën e huaj për të shkuar në shtëpi, veprime këto për të cilat ka shprehur pendesë të thellë, të dëmtuarit të mitur i kërkoi falje në prezencë të përfaqësuesit të tij ligjor babait të tij, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit të mituri dhe mbrojtëses së të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij dhe konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, si dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykatës i propozoi që ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Mbrojtësja e të pandehurit av. B. Sh. – M., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e saj, i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë siç edhe vetë deklaroi, e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, andaj me rastin e caktimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të dehur, ka bërë kompensimin e dëmit palës së dëmtuar të cilit i kërkoi falje, jeton në kushte të vështira ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, nga gjykata që të njëjtit t'i shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Përfaqësuesi ligjor i të miturit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dëmi i shkaktuar si rezultat i veprimeve të tij tani është kompensuar për arsye se biçikleta i është kthyer, më tej shtoi se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ngase tani nuk ndjehet i dëmtuar po ashtu nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtëses së të pandehurit dhe përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit të mitur, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën. par. 1.1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I pandehuri është shpallur fajtor për Veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën. par. 1.1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, për të cilën veprë ligjvënësi ka paraparë sanksionin penal dënim me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Konform nenit 71 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së është përcaktuar se: “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “... në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”.

Konform nenit 72 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim “...nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69, 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, në rastin konkret me rastin e aplikimit të dispozitave ligjore për zbutjen e dënimit nën kufirin e paraparë me ligj, si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti, keqardhjen e shprehur dhe pendimin për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, palës së dëmtuar sendi i vjedhur (biçikleta) i është kthyer, është prind i tre fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh faktin se nga të dhënat e siguruara nga evidenca penale rezulton se i pandehuri ka qenë edhe më parë i gjykuar për vepra tjera penale me vendim të formës së prerë dhe atë: për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega në Podujevë P.nr.500/2021, i datës 01.04.2022, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro, në kuadër të cilit i është llogaritur edhe koha e kaluar në ndalim prej dy ditësh, ashtu që i është mbetur detyrimi për të paguar shumën e gjobës në shumën prej dyqind e gjashtëdhjetë (260) Euro dhe dënim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale dhe veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.118/22, i datës 02.11.2023, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti në kuadër të cilit i është llogaritur koha e kaluar në ndalim dhe arrest shtëpiak, nga data 29.09.2021, deri me datë 29.10.2021 dhe dënim me gjobë në shumën prej një mijë (1,000) Euro, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 50 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të neneve 50, 52, 53 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:224687
Datë: 08.05.2024
Numri i dokumentit: 05661567

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr. 523/23, datë 03.05.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.